

V E N D I M
Nr. 228, datë 13.4.2001

**PËR DIETAT E NËPUNËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDBANIMIT
TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve, që financohen nga buxheti, kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimet e tyre, përfitojnë dietë në masën 10 për qind të pagës mujore, por pa kaluar 2000 (dy mijë) lekë në ditë dhe jo më pak se 1000 (një mijë) lekë në ditë. Shpenzimet e fjetjes paguhen sipas dokumenteve të paraqitura, që e vërtetojnë atë, por jo më shumë se 2000 lekë për çdo natë të fjetur. Shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas vlefës së biletës së udhëtimit me transport hekurudhor, automobilistik dhe ujqor. Kur udhëtimi bëhet me taksj apo furgona, shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas çmimeve të miratuara për linjën përkatëse me tren, autobus ose anije, plus 25 për qind të çmimit të biletës së transportit të linjës me autobus, dhe kur nuk ka linjë autobusi të trenit apo të anijes.

2. Dërgimi me shërbim jashtë rrethit ku banon nëpunësi dhe ku ka qendrën e punës, bëhet me autorizim të titullarit të institucionit ose të zëvendësit të autorizuar prej tij. Në autorizim përcaktohet koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij.

3. Për efekt të llogaritjes së dietës, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten bashkarisht, një ditë e plotë.

4. Personave, që nuk janë në marrëdhënie pune dhe dërgohen me shërbim, dieta u paguhet nga urdhëruesi i shërbimit, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e tjera, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

5. Punonjësit e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, kur shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës, për rastet kur përfitojnë dietë dhe kthehen brenda ditës, jashtë kohës normale të punës, përfitojnë dietë në masën 600 (gjashtëqind) lekë në ditë.

6. Nuk paguhet dietë kur shërbimi kryhet në qendrat dhe fshatrat që janë afër qyteteve ose qendrave të punës, në vendet ku ka shërbim transporti të vazhdueshëm dhe që përcaktohen me vendim të këshillit të qarkut.

7. Studentëve universitarë, parauniversitarë dhe nxënësve e kursantëve të shkollave të ndryshme, me ose pa bursë, kur dërgohen me shërbime të ndryshme: si praktika mësimore, ekspozita, shërbime me karakter mësimor etj. u paguhet dietë në masën 900 (nëntëqind) lekë në ditë.

Nxënësve dhe studentëve me bursë dhe gjysmë apo gjysëm bursë, për kohën që marrin dietë, u ndërpritet bursa për ushqim.

Trajtimi ushqimor i nxënësve dhe i studentëve, që gjatë kohës së praktikave mësimore nuk marrin dietë, por sistemohen në konvikte me mensë, të jetë në masën që ka konvikti përkatës, ku kryhet shërbimi.

8. Sportistët, trajnerët, gjyqtarët sportivë jovendas, për veprimtaritë, që zhvillohen ndërmjet rretheve, përfitojnë dietë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Sportistët, trajnerët, gjyqtarët sportivë jovendas, për veprimtaritë sportive që zhvillohen brenda rrethit, përfitojnë dietë në masën 600 (gjashtëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e udhëtimit për rastet kur u takon dietë. Sportistët e zonave të largëta, që nuk mund të kthehen brenda ditës, përfitojnë dietë në masën 700 (shtatëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të fjetjes.

Çiklistët për garat më të gjata se 50 km, vozitësit për garat më të gjata se 5 km, notarët, peshëngritësit, maratonistët dhe alpinistët gjatë ditëve të veprimtarive sportive marrin, përveç dietës, edhe një shtesë prej 400 (katërqind) lekësh në ditë.

9. Artistët e institucioneve kulturoro-artistike, kur shkojnë me shërbim për dhënie shfaqjesh jashtë rrethit, përfitojnë dietë në masën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

Për veprimtaritë kulturore me sistem grumbullimi, për konkurim olimpiade, festival filmash

dhe teatro profesioniste, masa e dietës të jetë 2000 (dy mijë) lekë në ditë, për rastet kur u takon dietë, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

10. Prefektët e qarkut që kryejnë funksione larg vendbanimeve të tyre, për sa kohë që nuk u janë siguruar kushtet për të marrë familjen me banim pranë vendit të punës, përfitojnë dietë dhe u paguhen shpenzimet e fjetjes sipas pikës 1 të këtij vendimi.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxhetet e institucioneve përkatëse, të miratuara për vitin 2001.

12.Vendimi nr. 549, datë 7.11.1994, i Këshillit të Ministrave, “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, si dhe vendimi nr. 320, datë 23.5.1998 i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 549, datë 7.11.1994, të Këshillit të Ministrave , “Për dietat e nëpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre”, si dhe çdo vendim apo akt tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

13. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta